



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

Nr 13146 / Prot.

Tiranë, më 9 / 9 / 2021

Lënda: Mbi dërgimin e Raportit për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm tek Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor

**AUTORITETIT SHETETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR** ✓

Adresa: *Rruga Papa Gjon Pali II 3, Tiranë*

Në zbatim të nenit 25 dhe 26, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, dhe Metodologjisë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020, në vijim të dërgimit të projekt raportit të përcjellë nëpërmjet shkresës së Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë nr. 13146, datë 21.07.2021, për të cilin nuk pati komente të mëtejshme nga ana e institucionit, bashkëlidhur, Ju dërgojmë "Raportin e vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm", për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor.

Të gjitha rekomandimet e përmendura në këtë raport duhet të përfshihen në planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi ky plan do të përbëjë bazën e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen, i cili dërgohet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së bashku me raportimin vjetor të institucionit për vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT  
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK  
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT

**RAPORT**

**VLERËSIMI I CILËSISË SË SISTEMIT TË  
KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

**DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË MENAXHIMIT FINANCIAR,  
KONTROLLIT DHE KONTABILITETIT**

**TEK**

**AUTORITETI SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPSINOR**

**GUSHT 2021**

## **PËRMBAJTJA**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	3
II. HYRJA.....	4
III. METODA E VLERËSIMIT .....	5
IV.GJETJET.....	6
4.1 MJEDISI I KONTROLLIT .....	6
4.2 MENAXHIMI I RISKUT .....	7
4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT .....	8
4.4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI .....	9
4.5 MONITORIMI.....	9
V. REKOMANDIMET .....	10

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit (DH/MFKK) është përgjegjëse për monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Me qëllim përmirësimit të standardeve të punës si dhe analizimin dhe vlerësimin me detaje të gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e rekomandimeve për adresimin e mangësive të identifikuara, në zbatim të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është hartuar Metodologjia për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 311, datë 23.12.2020. Në këtë kuadër, DH/MFKK ka planifikuar realizimin e procesit të vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme të përcaktuara në planin e miratuar të drejtorisë nr. 2642, datë 09.02.2021.

Procesi i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm do të shërbejë për identifikimin e mangësive kryesore të sistemit të kontrollit të brendshëm si dhe planifikimin e rekomandimeve të nevojshme për adresimin e tyre. Në përfundim të procesit të vlerësimit, hartohet një projekt-raport dhe raport i detajuar me gjetje dhe rekomandime të cilat duhet të ndiqen në vazhdimësi mbi ecurinë e veprimtarisë së tyre nëpërmjet planit të veprimit të MFK.

Përgjatë datave 28 Qershor-02 Korrik 2021, subjekti i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm ishte veprimtaria e Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) në fushën e kontrollit të brendshëm, njoftuar nëpërmjet shkresës nr. 10590/7, datë 15.06.2021, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Objektivat e vendosura lidhur me këtë vlerësim ishin:

- Verifikimi nga ana e DH/MFKK të gjendjes së zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (KB), duke ekzaminuar bazën dokumentare sipas secilës rubrikë të listës së kontrolleve;
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efijencës së këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektin e vlerësuar.

### Gjetjet dhe konkluzionet kryesore

Nga vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm rezultoi se:

1. Institucioni ka pasqyruar një informacion të plotë, gjithëpërfshirës dhe real në lidhje me statusin e zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në listën e kontrolleve;
2. Veprimtaria e institucionit mbështetet në dokumentin e rregullores së brendshme dhe kodin e etikës;
3. ASIG planifikon dhe analizon në bazë vjetore veprimtarinë e saj;
4. Veprimtaria e institucionit realizohet nëpërmjet zbatimit të planit vjetor të punës bazuar në objektiva, përbushja e të cilave monitorohet në mënyrë periodike nga strukturat përkatëse;
5. Procesi i menaxhimit të riskut është i strukturuar dhe menaxhohet nga strukturat përkatëse duke përcaktuar dhe vlerësuar risqet kryesore;
6. Rezultojnë të ndërtuara disa nga instrumentat kryesorë të menaxhimit financiar dhe kontrollit
7. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm, shërbim ky i mundësuar nëpërmjet marrëveshjes së lidhur me

Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të cilët kanë bërë një vlerësim të përgjithshëm për cilësinë e sistemit të KB si dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse;

8. Instrumenti i delegimit përdoret si një element i rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale.

### **Rekomandimet kryesore**

Mbështetur në gjetjet e konstatuara, për përmirësimin e situatës në zbatimin e sistemit të KB, rekomandojmë si më poshtë:

1. Rishikimi dhe ndërtimi i instrumentave të MFK (strategji risku, manuali i proceseve të punës dhe gjurmët e auditimit) në mbështetje të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Manualit të MFK;
2. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të menaxhimit të riskut në përputhje me ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimi nr.16 datë 20.07.2016 “Për koordinatorin e MFK dhe koordinatorin e riskut në njësitë publike”;
3. Përfshirjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik në realizimin e funksioneve ligjore për sa i përket fushës së MFK;
4. Përdorimin e instrumentit të delegimit në përputhje me bazat ligjore në fuqi të MFK (ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar dhe udhëzimi nr.4 datë 29.01.2020 “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”);
5. Të ndiqet zbatimi i planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së dhe të raportohet në mënyrë periodike te Nëpunësi Autorizues;
6. Nëpunësi Autorizues mund të monitorojë sistemin e KB nëpërmjet përdorimit të metodologjisë së monitorimit të performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm të njërive publike;

## **II. HYRJA**

Vlerësimi i cilësisë në ASIG bazohet në nenin 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 311, datë 23.12.2020.

Në përfundim të vlerësimit të mbështetur në listën e kontrollove të miratuar me urdhërin e sipërpërmendur hartohet ky projekt raport i vlerësimit të cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, dhe brenda **7 ditëve pune nga dërgimi i këtij projekt raporti**, niveli i lartë drejtues i ASIG mund të reagojë në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura.

Nëse nuk do të ketë asnjë reagim nga institucioni i vlerësuar atëherë do të konsiderohet i ezauruar ky hap dhe do të vijohet me dërgimin e raportit përfundimtar.

Nëse ASIG reagon, pas marrjes së komenteve me shkrim nga drejtuesi i institucionit, do të vijohet me organizimin e një takimi përmbyllës.

Pas realizimit të takimit përmbyllës me punonjësit e DH/MFKK, këta të fundit e konsiderojnë të përbushur misionin e tyre dhe dërgojnë raportin përfundimtar brenda **10 ditëve punë nga realizimi i**



Informacioni mbështetës për vlerësimin e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në ASIG janë lista e kontrolleve e plotësuar dhe dokumentacionet e paraqitura për secilën pikë, pyetësi i vetëvlerësimit, plani i veprimit të MFK, raporti vjetor për vlerësimin e sistemit të KB nga ana e ASIG, gjetjet e AB.

Vlerësimi nga grupi vlerësues u mbështet në dokumentacionet e sipërcituara.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në ASIG vlerësohet **efektiv**, me 65 pika të plotësuara nga lista e kontrolleve të shoqëruar me dokumentacion justifikues.

### III. METODA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm është e mbështetur në Metodologjinë për Vlerësimin e Cilësisë së Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme dhe realizohet përmes vlerësimit të efektivitetit të këtyre sistemeve përkatësisht në: efektiv, pjesërisht efektiv ose joefektiv:

- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **efektiv**, nëse nuk janë zbuluar asnjë ose janë zbuluar shumë pak dobësi dhe mangësi të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **pjesërisht efektiv**, nëse dobësitë dhe mangësitë e zbuluara vlerësohen si të mesme dhe / ose të ulëta dhe nuk janë zbuluar dobësi të rëndësishme dhe ngjarje të dëmshme për njësinë në zbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- Sistemi i Kontrollit të Brendshëm do të konsiderohet **jo efektiv** kur ekziston një mangësi e madhe në lidhje me funksionimin e një komponenti ose parimi përkatës, ose në lidhje me komponentët që veprojnë së bashku në një mënyrë të integruar për të gjithë njësinë dhe kjo mangësi ndikon direkt në moszbatimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Në vlerësimin e njësive të qeverisjes së përgjithshme merren në konsideratë:

- Lista e kontrolleve;
- Evidencat mbështetëse;
- Pyetësi i vetë-vlerësimit;
- Raporti vjetor i kontrollit të brendshëm;
- Vlerësimi i performancës sipas indikatorëve;
- Plani i veprimit të MFK;
- Gjetjet e AB dhe KLSH për fushën;
- Vlerësimin e mëparshëm (nëse ka) sipas kësaj metodologjie për njësitë e qeverisjes së përgjithshme të vlerësuara;

Vlerësimi i përgjithshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm llogaritet si më poshtë, në mbështetje të 17 parimeve për 5 komponentët COSO të MFK-së:

1. 71%-100% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plota- efektiv;
2. 41%-70% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plota- pjesërisht efektiv;
3. 0-40% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plota - jo efektiv.

3. 0-40% të përgjigjeve mbi listën e kontrolleve vlerësohen të sakta dhe të plota - jo efektiv.

Për sa më sipër, nëse njësia që do të vlerësohet rezulton me 48-68 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrolleve, do të cilësohet me një sistem të KB efektiv. Nëse rezulton me 28-47 pyetje të plotësuara në bazë dokumentare sipas listës së kontrolleve, do të cilësohet me një sistem të KB pjesërisht efektiv dhe 0-27, sistem të KB jo efektiv.

Informacionet përkatëse të vlerësimit përfshihen në Raportin Vjetor mbi Funkzionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme.

#### **IV.GJETJET**

Vlerësimi i cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm në ASIG u mbështet në listën e kontrolleve dhe dokumentacionet që e shoqërojnë atë, sipas parimeve përkatëse për secilin komponent të Modelit COSO.

##### **4.1 MJEDISI I KONTROLLIT**

Mjedisi i kontrollit i jep tonin njësisë, duke influencuar vetëdijen kontrolluese të njerëzve të saj. Ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm, pasi ai ngrë strukturën dhe vendos disiplinën. Faktorët e mjedisit të kontrollit të brendshëm përfshijnë integritetin, vlerat e etikës dhe profesionalizmin e punonjësve të njësisë; filozofinë dhe stilin e punës së titullarit, mënyrën se si drejtuesi shpërndan detyrat dhe ngarkon përgjegjësitë apo si organizon dhe zhvillon punonjësit në njësi, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

##### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 1 - Njësia Publike demonstron angazhim për integritet dhe vlerat etike.

Parimi 2 - Titullari / Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstrojnë pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Parimi 3 - Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.

Parimi 4 - Njësia publike demonstron angazhim në realizimin e kompetencave.

Parimi 5 - Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Rezultoi se:

1. Veprimtaria e ASIG mbështetet mbi bazën e Ligjit Nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 147, datë 20.2.2013, Për Miratimin e Rregullores "Për Organizimin dhe Funkzionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”;
2. Institucioni vepron mbi bazën e Rregullores së Brendshme miratuar me Urdhrin nr. 08 datë 31.08.2017. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për çdo strukturë të institucionit;
3. Kodi i etikës është miratuar si një dokument i veçantë me Urdhër nr. 28, datë 16.06.2015;
4. Ekziston rregullore për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike në ASIG, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 25.06.2015, ndryshuar me Vendimin nr. 5 datë 11.12.2019;
5. Institucioni ka hartuar Biznes-Planin Strategjik për periudhën 2015-2020;

6. Veprimtaria e ASIG bazohet në Strategjinë ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2015-2020”;
7. Objektivat e institucionit janë të përcaktuara në PBA 2021-2023, nr.126/6 datë 31.08.2020;
8. Për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19 me qëllim realizimin e objektivave të vendosur, është hartuar dhe vënë në zbatim plani i masave për mbrojtjen nga COVID-19. Njëkohësisht, stafi i ASIG është njohur me Urdhrin nr. 80 datë 17.11.2020 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarte të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 dhe kohëzgjatjes së vitit shkollor 2020-2021”, përcjellë me email datë 18.11.2020;
9. ASIG ka hartuar Planin e veprimit kundër korrupsionit 2018-2020, në kuadër të masave që qeveria shqiptare ka ndërmarrë duke luftuar në mënyrë efikase korrupsionin. Në këtë plan janë pasqyruar objektivat që ASIG synon të realizojë në kuadër të politikave për forcimin e luftës ndaj korrupsionit.
10. Institucioni ka hartuar planin vjetor të punës për vitin 2020 i cili është miratuar me memo-n nr. 10 prot., datë 09.01.2020;
11. Të gjitha strukturat në ASIG kanë kryer analizën vjetore të punës për vitin 2020 e cila është raportuar pranë nëpunësit autorizues dhe është miratuar me memo-n nr.15/1 prot., datë 20.01.2021;
12. Njëpërmjet shkresës nr. 336/1, datë 02.10.2019 është përcaktuar personi përgjegjës për masat antikorrupsion, njësia përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesave si dhe baza ligjore për “sinjalizuesin” (neni 10 i Ligjit 60/2016). Ndërkohë, institucioni nuk ka njësi përgjegjëse për sinjalizimin e brendshëm pasi nuk përmbush kriterin për numrin e punonjësve duke qënë se në strukturë ka 46 punonjës;
13. Përdoret delegimi si instrument i menaxhimit duke përfshirë edhe delegimin sipas kodit të procedurave administrative dhe ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
14. Përsa i përket funksionimit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, si një nga organet vendimarrëse lidhur me çështjet kryesore të institucionit, rezulton se ky grup është ngritur me Urdhrin nr. 28, datë 02.04.2020, i ndryshuar, dhe ka funksionuar në bazë të një axhende takimesh por njëpërmjet procesverbaleve evidentohet një mungesë në trajtimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;
15. Në këtë institucion respektohen procedurat ligjore të rekrutimit të punonjësve si dhe trajtohen kërkesat për rritjen e kapaciteteve njëpërmjet trajnimeve.

## 4.2 MENAXHIMI I RISKUT

Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit, kontrollit dhe monitorimit të atyre ngjarjeve ose situatave potencialisht të dëmshme për arritjen e objektivave të të gjithë njësisë publike dhe konceptohet për të dhënë garanci të arsyeshme se këto objektiva do të arrihen.

### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 6 - Specifikimi i objektivave të përshtatshëm.

Parimi 7 – Identifikimi dhe analiza e risqeve.

Parimi 8 – Mundësia e riskut të mashtrimeve.

Parimi 9 – Identifikimi dhe analiza e ndryshimeve të rëndësishme.



1. Është hartuar dhe miratuar regjistri i riskut i konsoliduar për të gjithë institucionin me urdhër nr. 84/1, datë 03.03.2020, por i pa shoqëruar me matricë risku apo strategji për menaxhimin e riskut për të gjithë institucionin duke rritur mundësinë e mosrealizimit të një procesi efektiv të monitorimit të risqeve;
2. Është hartuar dhe funksionon një Strategji Risku për pjesën dixhitale teknike;
3. Funksionet e Koordinatorit të Riskut mbulohen nga Nëpunësi Autorizues dhe këto funksione nuk janë deleguar;
4. Është ngritur Grupi i Menaxhimit të Riskut me Urdhrin nr.16, datë 19.02.2020 dhe janë zbatuar procedurat e menaxhimit të riskut sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për fushën.

#### 4.3 AKTIVITETET E KONTROLLIT

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësive duhet të marrin parasysh përfitimin që priten prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efektive.

##### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 10 –Përzgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të kontrollit.

Parimi 11 -Zgjedhja dhe zhvillimi i aktiviteteve të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.

Parimi 12 –Vendosja e aktiviteteve të kontrollit përmes politikave dhe procedurave.

Rezultoi se:

1. ASIG ka hartuar hartat e proceseve të punës për insitucionin, miratuar me memo nr. 131/8, datë 31.01.2018, por jo sipas strukturës së përcaktuar nga manuali i MFK;
2. Nuk janë ndërtuar manualet e proceseve të punës sipas formatit të përcaktuar nga DH/MFKK për ASIG, por hartat e përpiluara përmbajnë elementët kryesorë të manualit;
3. Nuk janë ndërtuar gjurmë auditimi për proceset kryesore të punës;
4. Delegimi i funksioneve realizohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, ligjin 90/2012 dhe ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
5. Përshkrimi i punës kryhet për çdo pozicion pune, bazuar në VKM-në nr.142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimet dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" i ndryshuar, të cilat përcillen në Departamentin e Administratës Publike për rishikim dhe miratim.
6. Të gjitha strukturat kryejnë periodikisht raportime 6-mujore mbi vlerësimin e punonjësve;
7. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr. 30 datë, 27.12.2011, ndryshuar “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike”;
8. Institucioni ka krijuar dhe disponon regjistrin e aktiveve në mënyrë progresive për periudhën 2014-2020;
9. Ka rregullore të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të teknologjisë së informacionit të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe gjithashtu ka sistem për ruajtjen e të dhënave.

9. Ka rregullore të brendshme që garantojnë sigurinë e sistemit të teknologjisë së informacionit të përcaktuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe gjithashtu ka sistem për ruajtjen e të dhënave.

#### **4.4 INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI**

Komponenti i katërt i kontrollit të brendshëm ka të bëjë me çështjet e informacionit dhe të komunikimit. Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësisve publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

#### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 13 -Marrja, gjenerimi dhe përdorimi i informacionit përkatës cilësor.

Parimi 14 -Komunikimi i brendshëm.

Parimi 15 -Komunikimi i jashtëm.

Rezultoi se :

1. Procesi i komunikimit në institucion është i strukturuar dhe funksionon në mënyrë efektive duke u realizuar nëpërmjet shkresave dhe email-eve zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit (memo, email);
2. Është hartuar një Plan Komunikimi i miratuar me memo-n nr. 407 Prot, datë 25.10.2017;
3. Raportimet mbi ecurinë e realizimit të aktiviteteve dhe objektivave kryhen në mënyrë periodike nga çdo strukturë për nëpunësin autorizues;
4. Informacioni i gjeneruar nga ASIG është i disponueshëm për publikun në faqen Web të institucionit [www.asig.gov.al](http://www.asig.gov.al), në Gjeoportalin Kombëtar si dhe në faqen përkatëse në rrjetet sociale. Në këtë kuadër, publiku ka akses për pyetje, informim dhe sugjerime.

#### **4.5 MONITORIMI**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efikente me kalimin e kohës. Në kryerjen e monitorimit, titullari i njësisë, nëpunësi autorizues dhe menaxherët e tjerë, duhet t'i kushtojnë vëmendje gjendjes së Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe objektivave të arritura.

### **Parimet që përfshihen në këtë komponent janë:**

Parimi 16 - Përzgjedhja, zhvillimi dhe kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme dhe / ose të veçanta.

Parimi 17 - Vlerësimi dhe komunikimi i mangësive.

Rezultoi se:

1. Raportohet në baza mujore dhe katër mujore për veprimtarinë financiare dhe operacionale në bazë të objektivave dhe referuar planit vjetor të punës;
2. Nuk rezulton ndonjë raportim i evidentuar me dokument tek GMS në lidhje me arritjen e objektivave dhe risqet shoqëruese të tyre;
3. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm realizohet nëpërmjet shërbimit të auditimit të brendshëm, shërbim ky i mundësuar nëpërmjet marrëveshjes së lidhur me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë sipas shkresës nr. 390/2 Prot., datë 11.12.2019;
4. Është realizuar monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe janë marrë masat konkrete për adresimin e problematikave, të reflektuara në Planin e Veprimit për ngritjen e sistemit të MFK.

### **V. REKOMANDIMET**

Në mbështetje të gjetjeve të sipërcituara, rekomandojmë sa më poshtë vijon:

1. Të hartohet Strategjia e Menaxhimit të Riskut, matrica e riskut dhe plani i veprimit për minimizimin e risqeve për të gjithë institucionin me qëllim menaxhimin aktiv të tyre ;
2. Në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe procedurave ekzistuese të punës, rekomandojmë të ndërtohen manualet e proceseve të punës për secilën drejtori sipas formatit të miratuar nga DH/MFKK;
3. Të ndërtohen gjurmët e auditimit për proceset kryesore të punës;
4. Gjatë takimeve të GMS të trajtohen problematikat që lidhen me MFK-në duke e shtrirë fokusin në vlerësimin e gjendjes së sistemit të kontrollit të brendshëm dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e këtij sistemi;
5. Të ndiqet zbatimi i planit të veprimit për ngritjen e sistemit të MFK-së 2021 dhe të raportohet në mënyrë periodike te Nëpunësi Autorizues;
6. Të formalizohen procedurat e delegimit sipas ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke mbajtur në konsideratë përmbajtjen e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 29.01.2020 “ Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
7. Të gjitha rekomandimet e sipërpërmendura duhet të përfshihen në planin e veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit pasi ky plan do të përbëjë bazën e punës për ndjekjen e procedurave në të ardhmen dhe duhet të dërgohet me shkresë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.